REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 49 datë 17.10.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "GODINË REZIDENCIALE ME 13 KATE NË JUG DHE 16 KATE NË VERI MBI TOKË DHE 2-5 KATE NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË ZONËN E LIQENIT TË THATË, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit" i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive "ASINVESTMENT" sh.p.k. dhe "B-INVESTMENT" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Godinë Rezidenciale me 13 kate në jug dhe 16 kate në veri mbi tokë dhe 2-5 kate nëntokë", me vendndodhje në zonën e Liqenit të Thatë, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqëritë "ASINVESTMENT" sh.p.k. dhe "B-INVESTMENT" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Vendimi Nr. 17, datë 04.10.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Godinë rezidenciale "Liqeni i Thatë", me vendndodhje në zonën e Liqenit të Thatë, Bashkia Tiranë", me subjekt zhvillues shoqërinë "ASINVESTMENT" sh.p.k.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKAÇI

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 31 /08/ 2026